

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit...
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	• Direktiva (BE) 2017/1132 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 qershorit 2017 lidhur me disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (kodifikim), FZ L 169, 30.6.2017, f. 46–127, ndryshuar kryesisht nga (i) Direktiva (BE) 2019/1151 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 qershorit 2019, që ndryshon Direktiven (BE) 2017/1132 sa i përket përdorimit të mjeteve dhe proceseve dixhitale në të drejtën e shoqërive tregtare, PE/25/2019/REV/1, FZ L 186, 11.7.2019, f. 80–104 (ii) Direktiva (BE) 2019/2121 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 nëntorit 2019, që ndryshon Direktiven (BE) 2017/1132 sa i përket shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare, PE/84/2019/REV/1, OJ L 321, 12.12.2019, f. 1–44
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027 Dokumenti i Vlerësimit të Ndikimit të Politikave
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e vlerësimit të ndikimit

A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po/Jo Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i> Ky raport vlerëson ndikimet e transpozimit të Direktivës (BE) 2019/1151 (që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132) dhe Rregullores Zbatuese (BE) 2021/1042 në legjislacionin shqiptar, me fokus përmirësimin e përdorimit të mjeteve dixhitale në të drejtën e shoqërive tregtare. Transpozimi synon ndërlidhjen ndër-regjistore përmes sistemit BRIS (Business Registers Interconnection System), shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet regjistrave kombëtarë, përdorimin e mjeteve dixhitale për depozitimin dhe publikimin e informacionit të shoqërive, njohjen e mjeteve të identifikimit elektronik të vendeve të BE-së, si dhe zbatimin e standardeve teknike të përcaktuara nga Rregullorja 2021/1042. Aktualisht, regjistrimi online i biznesit në Shqipëri është i mundur sipas ligjit nr. 9723/2007 për regjistrimin e biznesit (i ndryshuar). Ndryshimi i propozuar do të ndihmojë duke vendosur në dispozicion dhe publikuar në sistemin dhe faqen e QKB-së kopje të informacionit dhe dokumentacionit të përmendur lidhur me Sistemin e ndërlidhjes, siç përkufizohet në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit si dhe të emrit dhe formës ligjore të shoqërive, selinë dhe shtetin e regjistrimit, numrin unik të identifikimit të subjektit dhe identifikuesin unik evropian (EUID), faqen e internetit të shoqërive kur ky informacion është i regjistruar në ekstraktin tregtar, statusin e shoqërive, informacion mbi hapjen e procedurave të hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit apo falimentimit të shoqërisë ose çregjistrimin e shoqërisë nga regjistri etj.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)</i> Ky vlerësim i ndikimit rregullator (RIA) për harmonizimin e legjislacionit shqiptar për regjistrimin e biznesit me Direktivën 2017/1132 për sigurimin e përputhshmërisë me standardet e Bashkimit Evropian. Ky proces ka si qëllim krijimin e një mjedisi ligjor të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent për bizneset dhe investitorët. Po ashtu, ky vlerësim adreson nevojën për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe krijimin e një infrastrukture digjitale që do të mundësojë operacione të përbashkëta ndërkufitare dhe përputhshmëri me kërkesat e BE-së. Legjislacioni aktual nuk parashikon ende lidhjen e Regjistrat Tregtar Shqiptar me platformën evropiane BRIS dhe shkëmbimin automatik të të dhënave me regjistrat e huaj. Kjo krijon vakum në transparencë dhe pengesa për investitorët e huaj që kërkojnë informacion apo regjistrim biznesi në distancë.	
OPSIONET E POLITIKAVE <i>Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)</i> Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:	

Opsioni 0 (status quo)- nënkupton vijimin me kuadrin ligjor aktual. Ky nuk është një opsion i përshtatshëm për t'u zbatuar sepse mbajtja e kuadrit ligjor aktual pa reforma të rëndësishme do të çonte në mos përputhshmëri të vazhdueshme me direktivat kyçe të BE-së. Sipas këtij opsioni Shqipëria vazhdon me sistemin ekzistues pa u integruar në BRIS.

Opsioni 1 (Ndryshime në ligjin 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”) i preferuar - nënkupton ndryshimet në legjislacionin ekzistues. Ky opsion parashikon ndryshime ligjore e teknike për t'u lidhur me BRIS, për të njohur mjetet e identifikimit elektronik të BE-së dhe për të zbatuar standardet teknike të Direktivës (BE) 2019/2121 dhe më tutje të Rregullores 2021/1042. Ky opsion pas ndryshimit të ligjit 9723/2007, kërkon reflektim edhe në ligjin 131 të këtyre ndryshimeve, pasi përputhja me *acquis* është e domosdoshme në kuadër të integrimit evropian dhe sjell përfitime të rëndësishme.

Opsioni 2 (Jo rregullator): Një opsion jo rregullator do të nënkuptonte lejimin e bizneseve dhe aktorëve të tjerë të funksiononin pa një kuadër të detajuar rregullator ose me ndërhyrje minimale nga shteti, duke lejuar vetë-rregullimin dhe pajtimin vullnetar me standardet e BE-së. Ky opsion praktikisht do të bënte që sistemi shqiptar në kuptimin e ndërlidhjes me BRIS dhe përdorimi i mjeteve digjitale të mbetej në dorën e aktorëve të tregut si QKB-ja

Megjithatë, ky opsion është i papranueshëm për Shqipërinë, pasi vendi është i detyruar të harmonizojë legjislacionin e tij me kërkesat e BE-së për integrimin në tregun e brendshëm të BE-së. Mungesa e një kuadri të detajuar rregullator do të shkaktonte pasiguri ligjore, do të dëmtonte besimin e investitorëve dhe do të dëmtonte përpjekjet për të siguruar një mjedis të drejtë dhe transparent biznesi. Po ashtu, nuk do të ishte në përputhje me angazhimet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE dhe do të krijonte një ambient të pasigurt për zhvillimin e biznesit, duke penguar mundësitë për rritjen e investimeve të huaja dhe përmirësimin e konkurrencës.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Transpozimi pritet të ketë ndikim pozitiv neto. Administrata publike – veçanërisht QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) dhe AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) – do të kenë kosto fillestare për përditësimin e sistemeve IT (më shumë si rrjedhojë e ndryshimeve të ligjit për regjistrimin e biznesit sesa të ligjit për QKB-në, por që indirekt afektohet) dhe lidhjen me platformën evropiane, por këto investime do të rrisin eficiencën afatgjatë. Bizneset vendase do të përfitojnë nga procedura më të shpejta dhe transparente, pa ndonjë barrë shtesë financiare. Përdoruesit ndërkufitarë (investitorë të huaj, ortakë apo kreditorë jashtë vendit) do të kenë akses më të lehtë në shërbimet tona – p.sh. regjistrim firme apo marrje informacioni – duke përdorur identitetin elektronik të tyre të lëshuar në BE. Kjo ul kostot e tyre dhe pritet të nxisë investimet e huaja dhe besimin. Në disa vende të BE-së, dixhitalizimi i regjistrimit është dëshmuar shumë i suksesshëm: p.sh. në Estoni, Lituani¹ dhe Poloni mbi 75-85% e bizneseve të reja regjistrohen online², gjë që tregon përfitimet e këtyre reformave. Nga ana e transparencës, lidhja me BRIS bën që të dhënat bazë të shoqërive tona të jenë të aksesueshme falas nga çdo shtet anëtar, duke forcuar sigurinë e transaksioneve ndërkufitare. Nuk identifikohen ndikime negative të rëndësishme sociale apo mjedisore; përkundrazi, ulja e burokracisë dhe dokumenteve fizike ka efekt pozitiv mjedisor (më pak përdorim letrash) dhe përmirëson shërbimin ndaj qytetarëve..

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

¹ <https://link.springer.com/article/10.1007/s40804-023-00282-6#:~:text=member%20of%20the%20Polish%20Parliament,Footnote%20120>

² <https://hrcak.srce.hr/file/324822#:~:text=document%20queries%20as%20ell%20as,EU%20member%20states%20introduced%20eith>

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta).

Opsioni i preferuar është Opsioni 1- Ndryshime në legjislacionin ekzistues.

Ky opsion parashikon shtimin dhe modifikimin e neneve ekzistuese të ligjit nr. 131/2015, me qëllim integrimin e kërkesave të reja (si ato për digjitalizimin, ndërlidhjen e regjistrave dhe transparencën korporative) brenda kornizës aktuale ligjore. Kjo qasje merr parasysh se ligji ekzistues ka tashmë strukturat dhe procedurat bazë të krijuara, duke e bërë më të thjeshtë dhe më eficient ndërthurjen e elementeve të rinj, në vend të hartimit të një ligji nga e para.

Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret përkatëse, si dhe duke vlerësuar secilin opsion, rezulton se opsioni 1 ka prioritet krahasuar me opsionet e tjera.

Si rezultat, vlerësojmë se opsioni më i përshtatshëm do të jetë opsioni 1, i hartimit të ndryshimeve dhe/ose përshtatjeve ligjore të ligjeve ekzistuese.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë) është e vështirë të llogaritet me besueshmëri. Do të jetë e nevojshme të ndryshohet legjislacioni gjë që përkthehet në kosto për ekspertët, kosto për trajnime si dhe kosto për ndërgjegjësimin e grupeve të prekura siç janë bizneset. Në fazën fillestare është e vështirë të maten kostot me besueshmëri por mund të vlerësohet se ato nuk arrijnë më shumë se 10 milionë lekë në tre vitet e para, vlerë që nuk është e rëndësishme krahasimisht me përfitimet e pritshme:

Viti 1	Viti 2	Viti 3
10,000,000	10,000,000	10,000,000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në datën _____ me afat publikimi datën _____, me nr. shikimesh _____,

Sqarojmë se publikimi i projektligjit është bërë me titullin “ _____”, por bazuar në komentet e ardhura gjatë procesit të konsultimit me ministritë e linjës, projektligji është ripunuar në terësi.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Bazuar në projektligj, organet që parashikohen për zbatimin e nismës së propozuar janë:

- a) Ministria përgjegjëse për ekonominë;
- b) Qendra Kombëtare e Biznesit;
- c) Ministria përgjegjëse për financiat;
- d) Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Duke nisur prej muajit maj 2008, themelimi, organizimi dhe regjistrimi i shoqërive tregtare në Shqipëri rregullohet me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (ligji për shoqëritë tregtare) dhe Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”. Në vitin 2014, me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me direktivat e reja të BE-së, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime të mëtejshme me karakter më thelbësor në ligjin për shoqëritë tregtare. Dispozitat e legjislacionit tregtar duhen kërkuar në ligjin për shoqëritë tregtare dhe në ligjin për regjistrimin e biznesit. Procesi i reformimit të ligjit për shoqëritë tregtare nisi prej vitit 2007, kur qeveria shprehu vullnetin për reformimin e një strukture të përcaktuar qartë posaçërisht për veprimtaritë civile dhe tregtare dhe për organizatat tregtare, në bazë të këtyre ligjeve:

- Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, që parashikon format kryesore të organizimit të biznesit;
- Ligji për regjistrimin e biznesit, që parashikon regjistrimin dhe dhënien e informacioneve të organizatave të biznesit;
- Legjislacioni i posaçëm që rregullon çështje të veçanta të biznesit, si: ligji nr.9879, datë 21.2.2008, “Për titujt” sot ligji 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, etj.

Pas këtij riorganizimi, janë miratuar edhe disa ligje dhe dispozita të tjera që pjesërisht nuk janë të detyrueshme të tilla si Kodi i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare dhe Ligji për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare (ligji nr.110/2012).

Siç u shpjegua më sipër legjislacioni tregtar i hartuar në vitet 2007-2008 ka qenë një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit me kërkesat e BE-së, por ende ka nevojë për ndryshime dhe plotësime për të arritur përputhshmërinë e plotë me direktivat e BE-së. Në veçanti, përputhshmëria e ligjit shqiptar me Direktivën (BE) 2017/1132 lidhur me disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (kodifikim) (Direktiva e Kodifikuar), Direktivën (BE) 2019/1151 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket përdorimit të mjeteve dhe proceseve dixhitale në të drejtën e shoqërive tregtare (Direktiva për Mjetet Digjitale) dhe Direktivën (BE) 2019/2121 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare (Direktiva për Veprimtaritë Ndërkufitare), janë disa nga fushat ku Shqipëria ka ende hendeqe.

Procesi i integritetit të Shqipërisë në tregun e brendshëm të BE-së kërkon që vendi të krijojë një kuadër ligjor që është i harmonizuar plotësisht me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, shumë nga këto reforma janë të mbikëqyrura nga institucionet evropiane dhe nga autoritetet shqiptare.

Sipas Raportit të Progresit 2024 të Komisionit Evropian, të publikuar më 30 tetor 2024, Shqipëria vlerësohet për përparimin në harmonizimin e legjislacionit të shoqërive tregtare me *acquis-in* e BE-së nën Kapitullin 6. Komisioni rekomandon intensifikimin e përpjekjeve për përafrim të plotë me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar, duke theksuar nevojën për të adresuar boshllëqet në operacionet ndërkufitare, përdorimin e mjeteve digjitale dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatim efektiv, si pjesë e negociatave për anëtarësimin³.

Për shembull, një ndër arritjet është Qendra Kombëtare e Biznesit është përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive, duke mundësuar regjistrim të lirë online dhe akses në të dhëna nëpërmjet internetit. Në shkurt 2024, Qendra Kombëtare e Biznesit mori certifikimin ISO 9001:2015 për shërbimet në regjistrin e biznesit, regjistrin e licencave, autorizimeve dhe lejeve, si dhe regjistrin e pronarëve përfitues.

Analiza e boshllëqeve ligjore (LGA) për Kapitullin 6 nxjerr në pah disa mangësi të rëndësishme në përafrimin e legjislacionit shqiptar me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE)

³ Shih faqet 12 dhe 67 të Progress Raportit 2024.

2019/1151 dhe 2019/2121. Për kërkesat për publikimin e informacionit dhe përdorimin e mjeteve dixhitale, të dyja të trajtuara nën Titullin I, Kapitulli III të Direktivës, legjislacioni shqiptar përballlet me sfida të ngjashme. Ligji nr. 9723/2007 dhe nr. 9901/2008 sigurojnë regjistrimin dhe publikimin e informacionit bazë si emri, forma dhe selia, por nuk arrijnë të harmonizohen plotësisht me kërkesat e Direktivës 2017/1132 për zbulim të detajuar dhe të unifikuar të dokumenteve për përdoruesit ndërkufitarë, dhe as me standardet e Direktivës 2019/1151 për formatin dhe qartësinë e informacionit. Në të njëjtin kapitull, Direktiva kërkon gjithashtu publikimin dhe shkëmbimin e të dhënave për administratorët e përjashtuar përmes sistemit BRIS por Ligji nr. 9901/2008 dhe nr. 9723/2007 nuk përmendin mekanizma për regjistrimin dhe publikimin e administratorëve të përjashtuar, duke lënë një boshllëk në këtë aspekt, çka e bën përafrimin akoma të paplotë.

Sistemi elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) është i avancuar për regjistrim online, por nuk plotëson ndërveprueshmërinë me sistemin BRIS dhe identifikuesin unik sipas Nenit 22(2) të Direktivës 2019/1151, ndërsa informacioni për përdoruesit ndërkufitarë ka nevojë për përmirësim, duke mbajtur nivelin e përafrimit konsiderueshëm të lartë, por jo tërësisht të përafuar.

Si rrjedhojë e ndërhyrjeve rregullatore dhe ligjore për përafrimin e Direktivës 2017/1132, institucionet duhet të kenë parasysh se harmonizimi me standardet e BE-së kërkon edhe disa konsiderata strategjike që duhet të ecin paralelisht me ndryshimin e Direktivës 2017/1132. Së pari, alokimi i përgjegjësiave për transpozimin e këtyre kërkesave duhet të jetë i qartë dhe i koordinuar mes institucioneve kryesore si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria e Financave dhe QKB. Së dyti, mundësimi i planifikimit të përafrimit rregullator është thelbësor, duke kërkuar që ndryshimet legjislative për shoqëritë e listuara të sinkronizohen me ndërhyrjen rregullatore të kësaj RIA, për të krijuar një kuadër koherent që adreson jo vetëm kërkesat e Direktivës 2017/1132 por edhe të formave të reja të organizimit të shoqërive tregtare të kërkuara në kuadër të harmonizimit të Kapitullit 6⁴, që duhen regjistruar nga QKB dhe rrjedhimisht ndërlidhur sipas sistemeve të reja të BE-së ku QKB do të aderojë

Bazuar në nenin 70 të MSA-së, Shqipëria angazhohet të bëjë përafrim gradual të kuadrit të saj rregullator me acquis të BE-së, angazhim ky i ndërmarrë dhe në kuadër të negociatave të anëtarësimit në BE. Harmonizimi i legjislacionit të shoqërive tregtare me acquis respektiv të BE-së është objekt negociimi në Kapitullin 6 të negociatave “Legjislacioni i shoqërive tregtare”. Në takimin bilateral *screening*, më 3 shkurt 2023, Shqipëria shprehu angazhimin për përafrim të plotë të kuadrit të saj rregullator me acquis, ndër të tjera me Direktivën Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/1151 Direktiva (BE) 2019/2121, brenda vitit 2025.

Në këtë linjë vjen dhe angazhimi i qeverisë për përafrim të plotë rregullator me acquis të BE-së i cili rishprehet në Pozicionin Negociues për Kapitullin 6 të negociatave, si pjesë e Grupkapitujve 2 – Tregu i Brendshëm, ku vendi zotohet të mbyllë negociatat teknike brenda vitit 2027.

Për zbatimin e këtyre angazhimeve ligjore e politike, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027, MEKI parashikon masa për përafrimin rregullator të Direktivës së Kodifikuar, të ndryshuar, brenda vitit 2025, kjo me mbështetje të asistencës teknike ofruar nga Qeveria Gjermane, përmes GIZ.

Ligji nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” u miratua në vitin 2015 me synimin për të konsoliduar shërbimet e regjistrimit dhe licencimit të biznesit në një institucion të vetëm. Krijimi i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) shënoi bashkimin e dy enteve paraekzistuese – Qendrës Kombëtare të

⁴ Rregulloret e Këshillit të BE-së për format e veçanta ligjore evropiane, konkretisht:

- o Rregullorja (KE) nr. 2157/2001 për Shoqërinë Evropiane (SE),
- o Rregullorja (KEE) nr. 2137/85 për Grupimet Ekonomike me Interes Evropian (EEIG),
- o Rregullorja (KE) nr. 1435/2003 për Shoqërinë Kooperativë Evropiane (SCE).

Regjistrimit dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit – duke krijuar një sportel unik (one-stop shop) për sipërmarrësit në Shqipëri. Që nga ajo kohë, QKB-ja ka funksionuar si institucioni qendror që ofron regjistrimin e bizneseve dhe administrimin e licencave e lejeve, duke kontribuar në thjeshtimin e procedurave administrative dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Në vijim të zbatimit të këtij ligji, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për modernizimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe përshtatjen e tyre me praktikën bashkëkohore. Ndërkohë, procesi i integritimit evropian të Shqipërisë ka nxjerrë në pah nevojën për përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis*-in e Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) detyron vendin tonë të harmonizojë kuadrin ligjor në fusha të ndryshme, përfshirë atë të shoqërive tregtare. Në vitet pas krijimit të QKB-së, Bashkimi Evropian ka miratuar direktiva të reja, si p.sh. Direktivën (BE) 2017/1132 (të konsoliduar) mbi të drejtën e shoqërive tregtare dhe aktet e mëvonshme që e plotësojnë atë (përfshirë përdorimin e mjeteve digjitale dhe procedurat ndërkufitare të bizneseve). Këto zhvillime legjislative në nivelin e BE-së kërkojnë që edhe Shqipëria të përditësojë dhe plotësojë kornizën e vet ligjore për shoqëritë tregtare dhe regjistrimin e tyre. Për këtë arsye, ka lindur domosdoshmëria e rishikimit dhe ndryshimit të ligjit nr. 131/2015, në mënyrë që të reflektohen kërkesat bashkëkohore dhe të garantohet harmonizimi me standardet evropiane në këtë fushë.

Problemi në shqyrtim

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Shqipëria tashmë ka një kuadër ligjor që lejon regjistrimin elektronik të bizneseve. Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar) krijoi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (sot QKB) dhe hodhi bazat për regjistrimin “one-stop-shop” të subjekteve. Si rezultat, bizneset mund të regjistrohen pranë QKB-së pa pasur nevojë të ndjekin procedura të gjata gjyqësore; gjithashtu është zhvilluar infrastruktura për aplikime online (p.sh. portali e-Albania). Pra, Shqipëria ka avancuar në ofrimin e shërbimeve digjiutale në këtë fushë. Aktualisht çdo person i autorizuar mund të dorëzojë aplikimin elektronikisht për regjistrim biznesi dhe të marrë ekstraktin e regjistrimit online. Kjo praktikë tashmë ka thjeshtuar hapjen e bizneseve brenda vendit.

Megjithë ekzistencën e regjistrimit elektronik kombëtar, legjislacioni shqiptar nuk është i harmonizuar me zhvillimet më të reja të BE-së sa i takon ndërlidhjes ndër-regjistore dhe standardeve teknike evropiane.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe procesit të integritimit, Shqipëria ka detyrim të përafrojë legjislacionin me *acquis communautaire* të BE-së në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare. Direktiva (BE) 2019/1151 duhej transpozuar nga shtetet anëtare brenda datës 1 gusht 2021 (me disa shtyrje deri në 2022 për vendet që hasën vështirësi teknike). Si vend kandidat, Shqipëria synon të mos mbetet prapa këtyre afateve, për të qenë e gatshme brenda 2025-2026 të ketë një sistem plotësisht të harmonizuar. Mosveprimi do të sillte rrezik mospërputhjeje me standardet e BE – duke vështirësuar kapitujt e negociatave dhe përgatitjet për anëtarësim. Gjithastu investitorët e huaj mund të dekurajohen nga procedurat më të vështira ose mungesa e informacionit të lehtë, krahasuar me vende fqinje që tashmë i kanë këto lehtësi; Shkëmbimi manual i të dhënave me shtetet e tjera (p.sh. letra, e-mail jo të automatizuar) mund të shkaktojë vonesa dhe gabime në raste të bashkëpunimit ndër-institucional (si kur verifikohet ekzistenca e një shoqërie mëmë në një vend të BE kur regjistrohet dega e saj këtu, apo kur një shoqëri shqiptare hap degë jashtë).

Korniza aktuale ligjore “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” nuk e adreson plotësisht nevojën për harmonizim me disa nga parimet dhe kërkesat e reja të BE-së lidhur me shoqëritë tregtare. Kjo gjë ka krijuar

boshllëqe normative dhe sfida praktike. Konkretisht, ligji ekzistues nuk parasheh mekanizma për shkëmbimin ndërkufitar të informacionit të regjistrit tregtar midis Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së, ashtu siç kërkohet nga sistemi evropian i ndërlidhjes së regjistrave të biznesit (BRIS). Po ashtu, nuk janë të inkorporuara dispozitat që lehtësojnë përdorimin e mjeteve digjitale për regjistrimin elektronik të shoqërive apo për komunikimin elektronik ndërinstitucional, sipas praktikave më të mira evropiane. Përveç kësaj, disa standarde të qeverisjes korporative të promovuara nga BE (p.sh. transparencë e pronësisë, të drejtat e aksionarëve të vegjël, barazia gjinore në bordet drejtuese të shoqërive të listuara, etj.) ende nuk reflektohen sa duhet në kuadrin aktual ligjor. Shkakët e problemit lidhen kryesisht me faktin se legjislacioni ynë është hartuar para miratimit të këtyre direktivave dhe trendeve në nivelin e BE-së. Pa këto përditësime, Shqipëria rrezikon të mbetet prapa në procesin e harmonizimit ligjor, duke krijuar pengesa në integrimin e plotë në tregun e përbashkët evropian. Shtrirja e problemit është mbarëkombëtare, me ndikim të veçantë në mjedisin e biznesit dhe në përpjekjet e vendit për të tërhequr investime të huaja. Bizneset shqiptare që operojnë (ose synojnë të operojnë) edhe jashtë vendit hasin vështirësi për shkak të mungesës së rregullave të unifikuara me ato të BE-së – p.sh. në rastin e hapjes së degëve në vendet e BE-së, apo në kryerjen e operacioneve ndërkufitare si bashkimet apo ndarjet e shoqërive. Kjo situatë prek komunitetin e biznesit (shoqëritë tregtare vendase dhe investitorët e huaj), administratën publike (që ka detyrimin të zbatojë MSA-në dhe direktivat e BE-së), si dhe indirekt konsumatorët dhe publikun (që përfitojnë nga një treg i mirë-rregulluar dhe i besueshëm). Problemi në fjalë nuk mund të zgjidhet në mënyrë adekuate pa një ndërhyrje në politikat publike, konkretisht pa një ndryshim në legjislacion. Duke qenë se kërkesat për harmonizim burojnë nga direktiva dhe rregullore të detyrueshme të BE-së, adresimi i tyre kërkon masa normative nga ana e qeverisë dhe Kuvendit. Veprimet vullnetare ose vetë-rregullimi nga bizneset nuk do të ishin të mjaftueshme në këtë rast, pasi bëhet fjalë për krijimin e mekanizmave ligjorë dhe infrastrukturës institucionale që vetëm shteti mund t'i vendosë. Prandaj, ndërhyrja rregullatore konsiderohet e domosdoshme për të trajtuar problemin e identifikuar.

Natyra e problemit

Përmbledhtas, problemi kryesor është hendeuku midis sistemit kombëtar dhe atij evropian në drejtën e shoqërive: Shqipëria ka themelet e duhura për regjistrimin online, por i mungon ndërlidhja dhe standardizimi ndërkombëtar. Kjo kërkon një ndërhyrje rregullatore për plotësimin e boshllëkut dhe modernizimin e mëtejshëm të sistemit tonë.

Kjo mos përputhshmëri sjell pasiguri ligjore për bizneset dhe investitorët, duke penguar krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues. Gjithashtu, ajo rrezikon mosarritjen e objektivave për anëtarësimin në BE deri në 2030 dhe mbylljen e negociatave teknike brenda 2027-ës, duke vështirësuar integrimin e plotë të Shqipërisë në tregun e brendshëm evropian.

Sistemi elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) është i avancuar për regjistrimin dhe filing-un online, duke ofruar një bazë solide për përafrim me Direktivën 2019/1151, por ka mangësi në ndërveprueshmërinë me sistemin BRIS dhe në përdorimin e një identifikuesi unik sipas Nenit 22(2), i cili duhet të sigurojë identifikimin e qartë të shoqërive në komunikimet ndërkufitare. Përveç kësaj, informacioni i ofruar për përdoruesit ndërkufitarë nuk është ende aq konciz sa kërkohet nga Direktiva, duke kërkuar përmirësime shtesë për të arritur standardet e nevojshme digjitale për operacionet e biznesit në nivel evropian. Këto boshllëqe tregojnë se pavarësisht një niveli të konsiderueshëm përafrimi në disa fusha, legjislacioni shqiptar kërkon ndërhyrje të mëtejshme.

Shkakët e problemit

Shkakët e këtij problemi mund të kategorizohen sipas tipologjisë së mëposhtme, duke filluar me mos përputhjet rregullatore si shkaku primar.

Së pari, diferenca mes Direktivës (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE) 2019/1151 dhe 2019/2121, dhe legjislacionit shqiptar përbëjnë një sfidë kryesore. Kjo mos përputhje rrjedh edhe nga evolucionet e Direktivës në kohë, të cilat kanë futur kërkesa të reja duke bërë që legjislacioni shqiptar, megjithëse ofron një bazë të mirë për disa aspekte si formimi dhe regjistrimi, nuk kanë përditësimet e nevojshme për të arritur përputhshmëri të plotë me standardet e përditësuara të BE-së.

Së dyti, mungesa e kapaciteteve institucionale për të zbatuar dhe monitoruar ndryshimet ligjore është një faktor shtesë. Institucionet si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), pavarësisht funksionimit elektronik, përballen me kufizime në burime dhe ekspertizë për të garantuar ndërveprueshmërinë me sistemin BRIS dhe për të zbatuar kërkesat komplekse të Direktivës, si shkëmbimi i informacionit⁵.

Së treti, infrastruktura digjitale, ndonëse e avancuar për regjistrim online, mbetet e pamjaftueshme për të plotësuar standardet e plota të Direktivës 2019/1151, duke përfshirë identifikuesin unik dhe ofrimin e informacionit të qartë për përdoruesit ndërkufitarë, çka mund të sjellë vonesa në investime dhe aftësi për të përmbushur kërkesat e tregut për operacione ndërkufitare dhe dixhitalizim të plotë.

Shtrirja e problemit

Problemi ka një shtrirje të gjerë, duke prekur të gjitha shoqëritë tregtare në Shqipëri, veçanërisht ato të angazhuara në operacione ndërkufitare, bashkime dhe ndarje. Sipas raportit të INSTAT për 2023, nga 226,778 njësitë ligjore aktive, 28,292 SHPK dhe 716 SHA mund të ndikohen drejtpërdrejt nga mungesa e harmonizimit, ndërsa 5.3% e ndërmarrjeve me kapital të huaj (rreth 6,900 entitete) përballen me pengesa në transaksione ndërkufitare, për shembull, vonesa në regjistrimin e bashkimeve për shkak të mungesës së ndërveprueshmërisë me BRIS-in. Kjo situatë sjell pasoja ekonomike të rëndësishme, duke përfshirë reduktimin e investimeve të huaja për shkak të pasigurisë ligjore dhe rritjen e barrës administrative për bizneset, sidomos NVM-të, të cilat përbëjnë 86.2% të ndërmarrjeve aktive dhe vuajnë nga kosto shtesë për përshtatje me standarde të paplotë.

Për të siguruar harmonizimin e plotë me Direktiva 2017/1132 dhe për të adresuar çështjet e ngritura, ndërhyrjet rregullatore duhet të bëhen në një masë të plotë që siguron harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar me kërkesat e BE-së. Kjo do të kërkojë përditësimin dhe ndryshimin e legjislacionit ekzistues, duke plotësuar boshllëqet dhe duke përshtatur rregullat dhe procedurat për të përmbushur standardet e reja të kërkuara nga Direktiva. Përshtatjet duhet të bëhen në disa nivele:

1. Ndërhyrjet duhet të përfshijnë harmonizimin e procedurave të regjistrimit dhe shpalljes së shoqërive duke siguruar përdorimin e plotë të mjeteve digjitale dhe mundësinë për të bërë regjistrime dhe komunikime online, në përputhje me kërkesat e Direktiva 2017/1132 për transparencën dhe aksesin e përdoruesve. Përshtatja duhet të jetë e plotë, përfshirë sistemin e ndërveprueshmërisë me regjistrat e tjerë të BE-së (BRIS).
2. Ndërhyrja rregullatore duhet të përfshijë krijimin e një sistemi që mundëson shpërndarjen e informacionit përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave (BRIS), duke u siguruar që identifikuesi unik të garantojë identifikimin e qartë të shoqërive shqiptare në komunikimet ndërkufitare. Kjo ndërhyrje duhet të bazohet në specifikimet teknike të përcaktuara nga Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) 2021/1042, e datës 18 qershor 2021, e cila parashtron rregullat për zbatimin e Direktivës (BE) 2017/1132 lidhur me standardet teknike dhe procedurat për sistemin e ndërlidhjes së regjistrave, duke zëvendësuar Rregulloren e mëparshme (BE) 2020/2244. Për këtë çështje, një Vlerësim i Ndikimit Rregullator (RIA) paralel është përgatitur tashmë, duke ofruar një bazë për të adresuar kërkesat specifike të ndërlidhjes. Një vlerësim i thelluar është i nevojshëm për të përcaktuar nëse sistemi aktual i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Shqipëri mund të përmbushë këto

⁵ Po ashtu, në lidhje me identifikuesin unik të kërkuar nga Direktiva, identifikuesi unik që përdoret aktualisht në Shqipëri mund të mos lejojë identifikimin e qartë të shoqërive shqiptare në komunikimet ndërmjet regjistrave përmes sistemit të ndërlidhjes së regjistrave të qendrueshëm, tregtar dhe të shoqërive, siç është parashikuar në Nenin 22(2) ("sistemi i ndërlidhjes së regjistrave"). Ai mund të mos përmbajë, të paktën, elementë që mundësojnë identifikimin e regjistrat të Shtetit Anëtar, regjistrin e brendshëm të origjinës dhe numrin e shoqërisë në atë regjistr dhe, kur është e nevojshme, karakteristika për të shmangur gabimet e identifikimit. Megjithatë, kjo duhet të vlerësohet në lidhje me Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) 2021/1042. Për më tepër, siç kërket nga Direktiva, është e nevojshme të përmirësohet më tej ofrimi i informacionit të qartë dhe të lehtë për përdoruesit ndërkufitarë.

standarde të reja, duke përfshirë kushtet teknike për ndërlidhjes me BRIS-in dhe aftësinë për të plotësuar kërkesat praktike, si shkëmbimi në kohë reale i të dhënave dhe përshtatja me formatet e unifikuara evropiane..

Në përgjithësi, ndërhyrjet duhet të bëhen në një masë të plotë që i mundëson Shqipërisë të përmbushë plotësisht kërkesat e BE-së, duke i sjellë ato në legjislacionin aktual, pa krijuar ndryshime të panevojshme të strukturës ligjore të vendit. Ky proces duhet të përfshijë konsultime të vazhdueshme me aktorët e përfshirë, duke siguruar që legjislacioni të jetë funksional dhe në përputhje me kërkesat e BE-së për transparencë, siguri dhe mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Grupet kryesore që preken nga ky problem janë:

Grupet kryesore të prekura nga mungesa e harmonizimit me Direktivën (BE) 2017/1132 mund të grupohen si më poshtë për të pasqyruar impaktin e gjerë të këtij problemi.

Së pari, qeveria dhe institucionet e saj, përfshirë Ministrinë përgjegjëse për Ekonominë (MEKI), Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), Ministrinë përgjegjëse për Financat, Administrata tatimore, Ministrinë përgjegjëse për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe AKSHI përballen me presionin për të menaxhuar dhe monitoruar ndryshimet ligjore për të arritur përputhshmërinë me standardet e BE-së. Këto institucione luajnë një rol vendimtar në hartimin e reformave, përditësimin e infrastrukturës rregullatore dhe mbështetjen e shoqërive për të zbatuar kërkesat e reja, duke kërkuar koordinim të shtuar dhe burime të dedikuara.

Së dyti, bizneset, me një vëmendje të veçantë ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), preken drejtpërdrejt nga ky problem.

Së treti, shoqëria civile, përfshirë shoqatat e biznesit, është një grup tjetër i prekur që meriton vëmendje. Këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e interesave të bizneseve dhe mund të ndikohen nga mungesa e qartësisë ligjore, duke pasur vështirësi në këshillimin e anëtarëve për operacione të tilla si bashkimet apo ndarjet. Për më tepër, ato mund të shërbejnë si urë lidhëse mes qeverisë dhe sektorit privat për të nxitur dialogun dhe për të lehtësuar zbatimin e reformave.

Së katërti, qytetarët që dëshirojnë të hapin shoqëri tregtare preken gjithashtu nga ky problem. Ndryshimet ligjore të parashikuara mund të prekin individët që synojnë të krijojnë biznese, të cilët mund të hasin pengesa (për shkak të njohurive të kufizuara) në proceset e regjistrimit, qasjen në informacion dhe përdorimin e procedurave digjitale, gjë që mund të dekurajojë sipërmarrjen dhe të vonojë nismat e tyre ekonomike, veçanërisht në një kontekst ndërkufitar.

Sipas të dhënave të disponueshme në Raportin e Regjistrave të Biznesit përgatitur nga INSTAT për vitin 2023, është përgatitur dhe një analizë ndikimi bazuar në të dhënat aktuale të shoqërive në Shqipëri.

Në vitin 2023, në Shqipëri janë 226,778 njësitë ligjore aktive, që përfshijnë një gamë të gjerë entitetesh, si Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar Shoqëritë Aksionare dhe forma të tjera ligjore. Prej këtyre, gjithsej 28,292 janë SHPK dhe 716 janë SHA. Entitetet e tjera ligjore janë të klasifikuara në forma të ndryshme, siç janë entitetet publike, OJQ-të dhe struktura të tjera jo-korporative.

Nga 130,338 ndërmarrje aktive (përfshirë fermerët), shumica janë ndërmarrje të vogla: 86.2% e tyre janë "prodhues të shërbimeve", përfshirë industrinë e tregtisë (44,267), akomodimin dhe shërbimet e ushqimit (17,962), dhe shërbime të tjera (38,299). Numri i ndërmarrjeve të mëdha (me më shumë se 50 punonjës) është relativisht i vogël, duke përbërë vetëm 1.6% të totalit, por ato punësojnë 50% të forcës së punës dhe gjenerojnë 45.3% të xhiros totale. Kjo tregon se, megjithëse shumica e ndërmarrjeve janë të vogla në madhësi, ato të mëdha kontribuojnë disproporcionalisht në ekonomi.

Duke marrë parasysh këto statistika, ndryshimet që do të vendosen për harmonizimin e ligjit shqiptar me Direktivën 2017/1132 do të prekin të gjitha shoqëritë, veçanërisht ato që janë angazhuar në operacione ndërkufitare. Shoqëritë do të duhet të përditësojnë statutet dhe dokumentet e tyre organizative për të siguruar që ato përputhen me kërkesat e reja.

Një tjetër grup që preket janë dhe noterët lidhur me rolin e tyre në bashkimet ndërkufitare. Direktiva 2005/56/KE, e cila trajtonte bashkimet ndërkufitare, është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga Direktiva 2017/1132 (Direktiva e Kodifikuar), veçanërisht nga dispozitat që lidhen me shndërrimet ndërkufitare, bashkimet dhe ndarjet. Megjithatë, ka një theks të shtuar në sigurinë që procedurat janë të efektshme dhe të harmonizuara me sistemet ndërkufitare të regjistrave, që do të përmirësojnë bashkëpunimin dhe transparencën ndërmjet shteteve anëtare. Kjo mund të kërkojë që noterët të përshtatin praktikën e tyre për t'iu përshtatur infrastrukturës digjitale të sistemeve të ndërlidhur për regjistrat e shoqërive në BE. Ndikimi rregullator për noterët është kryesisht i lidhur me këto përshtatje procedurale, duke siguruar përputhshmërinë me kuadrin e ri ligjor të BE-së dhe duke kontribuar në një proces më të thjeshtë dhe efikas për shoqëritë që angazhohen në operacione ndërkufitare brenda BE-së.

Vlerësimi i mundësisë për të trajtuar problemin përmes një ndryshimi të politikave

Ky problem mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave, veçanërisht duke miratuar ligje dhe rregullore që do të adresojnë boshllëqet ligjore ekzistuese dhe do të krijojnë një mjedis ligjor të harmonizuar plotësisht me standardet e BE-së, detyrim ky sipas nenit 70 të MSA-së. Prandaj, trajtimi i këtij problemi kërkon domosdoshmërisht ndërhyrje rregullore, si e vetmja mënyrë për të adresuar natyrën e tij dhe për të arritur harmonizimin me standardet e BE-së. Ndryshimi rregullator është i nevojshëm në dy drejtime kryesore. Së pari, politikisht, ai përfaqëson një angazhim të marrë në kuadër të negociatave të anëtarësimit në BE, ku përafrimi me *acquis-in*, përfshirë Direktivën (BE) 2017/1132, është një prioritet për mbylljen e Kapitullit 6 dhe avancimin e procesit të integritetit. Së dyti, ligjërisht, ky ndryshim rrjedh nga detyrimet e përcaktuara në Nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), e cila angazhon Shqipërinë për të harmonizuar gradualisht legjislacionin vendas me atë të BE-së. Prandaj, miratimi i ligjeve dhe rregulloreve të reja për të mbyllur boshllëqet ligjore ekzistuese duke përfshirë rregulla që forcojnë transparencën, mbrojnë të drejtat e aksionarëve dhe nxisin qeverisjen korporative të qëndrueshme përbën bazën e vetme për zgjidhjen efektive të problemit dhe krijimin e një mjedisi ligjor plotësisht të përafruar me standardet evropiane.

Megjithatë, masa të tjera plotësuese jorregullore mund të mbështesin këtë proces, pa mundur të zëvendësojnë ndërhyrjen rregullore. Për shembull, organizimi i trajnimeve për profesionistët ligjorë dhe punonjësit e institucioneve si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) apo MEKI-t mund të rrisë kapacitetet për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat komplekse të Direktivës. Po ashtu, ofrimi i mbështetjes teknike dhe programeve trajnuese për bizneset dhe zyrtarët mund të lehtësojë përshtatjen me rregullat e reja dhe të përshejtojë zbatimin praktik të reformave. Fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), mund të rrisin njohuritë për përfitimet e një kuadri ligjor të harmonizuar. Konsultimet me palët e interesuara, si shoqatat e biznesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave specifike dhe në përshtatjen e zbatimit të rregullave të reja për të minimizuar sfidat praktike, duke krijuar një proces më gjithëpërfshirës dhe të mbështetur. Gjithashtu, ofrimi i asistencës teknike përmes bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë si GIZ ose institucione të BE së mund të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës digjitale të QKB-së dhe përmirësimin e aftësive administrative për të plotësuar standardet teknike të ndërlidhjes me sistemin BRIS.

Këto masa, ndonëse të dobishme për të adresuar sfidat e mbetura dhe për të përmirësuar efikasitetin, mbeten dytësore dhe nuk mund të kompensojnë mungesën e një kuadri ligjor të plotë dhe të zbatueshëm, i cili mbetet thelbësor për zgjidhjen përfundimtare të problemit..

Arsyeja e ndërhyrjes

6. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
7. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

8. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
9. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Arsyeja për Ndërhyrje

Nisur nga problematikat e evidentuara më sipër, lind domosdoshmëria e ndërhyrjes së qeverisë për të ndryshuar dhe plotësuar kuadrin ligjor, duke trajtuar boshllëqet që kërkojnë një rregullim më të plotë për të arritur harmonizimin e plotë me *acquis-in* e BE-së. Qeveria e Shqipërisë e konsideron këtë ndërhyrje të nevojshme jo vetëm për të përmbushur detyrimet ligjore dhe politike, por edhe si parakusht për mbylljen e negociatave teknike me Bashkimin Evropian për Kapitullin 6 brenda vitit 2027, siç parashikohet në Pozicionin Negociues për këtë kapitull të miratuar në Janar 2025, dhe për anëtarësimin e vendit në BE brenda vitit 2030, datë kjo e përcaktuar si objektiv në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2030.

Qeveria e konsideron të nevojshme ndërhyrjen rregullatore për disa arsye themelore. Së pari, ekziston një detyrim ligjor dhe politik për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, si pjesë e procesit të integritimit. Neni 70 i MSA-së dhe angazhimet e tjera dypalëshe me BE-në e bëjnë të qartë se Shqipëria duhet të transpozojë në ligjin e brendshëm direktivat evropiane në fushën e së drejtës së shoqërive. Mospërmbushja e këtyre detyrimeve do të cenonte progresin integruar të vendit dhe mund të sillte pasoja negative, si vlerësime jo të favorshme në raportet e progresit apo vonesa në hapjen e kapitujve negociues. Së dyti, nga këndvështrimi i brendshëm ekonomik dhe shoqëror, ndërhyrja synon të adresojë pengesat aktuale që hasin bizneset dhe investitorët. Qeveria shpreson që, me anë të kësaj ndërhyrjeje ligjore, të krijojë kushte më të favorshme për të bërë biznes në Shqipëri: procedura më të shpejta dhe më pak të kushtueshme të regjistrimit, siguri juridike më e madhe në operacionet e shoqërive (sidomos ato ndërkufitare), dhe një kuadër më transparent që mbron më mirë të drejtat e aksionarëve dhe palëve të tjera të interesuara. Kjo ndërhyrje pritet të ketë ndikim pozitiv në klimën e investimeve, duke rritur besimin e investitorëve të huaj dhe vendas se Shqipëria ka një treg të formalizuar dhe të parashikueshëm. Së treti, kjo nismë lidhet drejtpërdrejt me objektivat strategjike të Qeverisë Shqiptare për zhvillim dhe integrim. Përputhja e legjislacionit për shoqëritë tregtare me standardet e BE-së kontribuon në zhvillimin ekonomik afatgjatë (duke inkurajuar investime dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme), në mirëqeverisjen (përmes transparencës dhe llogaridhënies më të madhe të kompanive), si dhe në agjendën e digjitalizimit (duke integruar mjete elektronike në shërbimet publike për bizneset). Deri tani, janë bërë disa hapa paraprakë në këtë drejtim: institucionet përkatëse kanë kryer analiza të brendshme për të identifikuar boshllëqet ligjore, si dhe janë zhvilluar konsultime fillestare me grupe interesi (si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, shoqatat e biznesit, etj.) për të marrë opinione mbi nevojat dhe ndikimet e mundshme. Këto përpjekje fillestare e kanë bindur më tej qeverinë se ndryshimet ligjore janë të justifikuara dhe urgjente.

Si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues për zhvillimin ekonomik. Harmonizimi është një hap kyç për të siguruar që Shqipëria të përmbushë kriteret e kërkuara për anëtarësim në BE dhe për të rritur pozicionin e saj në tregjet ndërkombëtare. Harmonizimi realizohet duke u mbështetur në disa dokumente strategjike kyçe:

- **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA):** Sipas Nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me atë të BE-së. Kjo ndërhyrje rregullatore plotëson këtë kërkesë duke harmonizuar legjislacionin e shoqërive tregtare me Direktivën (BE) 2017/1132, duke forcuar kështu bazën ligjore për anëtarësimin në BE.
- **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027:** Harmonizimi me *acquis-in* e BE-së është një prioritet i përcaktuar në PKIE, veçanërisht për mbylljen e Kapitullit 6 të negociatave me BE brenda vitit 2027. Kjo ndërhyrje është një hap konkret drejt përmbushjes së këtij objekti, duke avancuar negociatat teknike dhe përgatitjen për tregun e brendshëm evropian.

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2030:** Kjo ndërhyrje mbështet vizionin afatgjatë të SKZHI 2030 për anëtarësimin e Shqipërisë në BE deri në vitin 2030. Duke përafuar standardet rregullatore me ato të BE-së, ajo siguron që vendi të jetë i gatshëm për integrimin e plotë në tregun evropian, duke kontribuar në stabilitetin dhe prosperitetin ekonomik.
- **Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2025-2030:** Sipas këtij dokumenti, të hartuar në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndërhyrja rregullatore përkon me qëllimin për të stimuluar rritjen e ekosistemit të startup-eve dhe për të zhvilluar sektorët me prioritet ekonomik si turizmi, energjia, bujqësia dhe ICT/BPO. Kjo strategji synon të rrisë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e këtyre sektorëve duke mbështetur sipërmarrjen inovative, dhe harmonizimi i ligjit të shoqërive tregtare me BE-në—përfshirë modernizimin digjital dhe operacionet ndërkufitare—fuqizon bizneset shqiptare për të çelur tregje të reja dhe për të konkurruar në nivel ndërkombëtar, duke përshpejtuar rrugëtimin drejt BE-së 2030.
- **Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (BIDS):** Në linjë me objektivat e saj për të përmirësuar klimën e biznesit, kjo ndërhyrje nxit zhvillimin e sektorit privat përmes forcimit të qeverisjes korporative dhe mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve, duke e bërë Shqipërinë më tërheqëse për investime të huaja të drejtpërdrejta dhe duke mbështetur rritjen ekonomike.

Duke harmonizuar legjislacionin me standardet e BE-së, kjo ndërhyrje jo vetëm që përmbush kërkesat për integrim evropian, por edhe krijon mundësi të reja për investime dhe inovacion, veçanërisht për startup-et dhe sektorët strategjikë të identifikuar në Strategjinë e Sipërmarrjes Inovative. Ajo rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare duke lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe duke forcuar stabilitetin ekonomik, në përputhje të plotë me prioritetet e qeverisë për zhvillim dhe integrim afatgjatë.

Punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Reformat kryesore ligjore konsistojnë në:

Ligji nr. 43/2023 për qeverisjen elektronike ka një lidhje të ngushtë me kërkesat e Kapitullit 6 të BE-sepse ai ofron një bazë ligjore dhe digjitale të qëndrueshme për zhvillimin e administratës dhe shërbimeve të biznesit, duke mundësuar një sistem transparent, efikas dhe të sigurt për regjistrimin dhe menaxhimin e shoqërive. Ky ligj është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe përmbushjes së kërkesave të BE-së për zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm për biznesin dhe investitorët.

Digitalizimi i regjistrimit të bizneseve

Në përputhje me reformat legjislative, Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në digitalizimin e shërbimeve publike, veçanërisht në regjistrimin e bizneseve:

Portali e-Albania: I nisur në vitin 2014, portali e-Albania shërben si një platformë e centralizuar për aksesimin e shërbimeve publike. Ai u mundëson bizneseve të regjistrohen, të dërgojnë dokumente dhe të aksesojnë shërbime të ndryshme online, duke reduktuar nevojën për vizita fizike dhe rritur efikasitetin.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): QKB ka luajtur një rol kyç në digjitalizimin e proceseve të regjistrimit të bizneseve. Që nga dhjetori i vitit 2014, ajo ofron shërbime regjistrimi online, duke reduktuar ndjeshëm kohën e procesimit dhe ngarkesat administrative. Në vitin 2022, u bënë mbi 787,800 aplikime për 178 shërbime biznesi përmes QKB. Në shkurt të vitit 2024, Qendra Kombëtare e Biznesit mori certifikimin ISO 9001:2015 për shërbimet në regjistrin e bizneseve, regjistrin e licencave, autorizimeve dhe lejeve, dhe regjistrin e pronarëve të vërtetë. Ky certifikim thekson angazhimin e QKB për cilësi dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve.

Në kuadër të përpjekjeve për harmonizimin me *acquis-in* e BE-së për Kapitullin 6, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në bashkëpunim me Grupin Negociator të Integritimit Evropian, ka ndërmarrë punë të rëndësishme për të avancuar procesin e harmonizimit të legjislacionit të shoqërive tregtare, duke u mbështetur në analizat e detajuara si Vlerësimi i Boshllëqeve Legjislative (LGA), Vlerësimi i Boshllëqeve Institucionale dhe Administrative (IAGA), dhe Vlerësimi i Ndikimit të Politikave (PIA) për Qeverisjen Korporative të Shoqërive të Listuara..

LGA: LGA-ja, identifikon boshllëqe mes legjislacionit shqiptar dhe Direktivës 2017/1132, duke treguar përafrim të mirë por mangësi në çështjet e përmendura përgjatë kësaj RIA, si dhe nevojën për harmonizim të plotë, duke propozuar ndërhyrje legjislative për përmbushjen e standardeve të BE-së.

IAGA: IAGA-ja thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për interpretimin, transpozimin, zbatimin dhe monitorimin e ligjit të BE-së për shoqëritë, duke përfshirë krijimin e kushteve për formimin online të shoqërive, përmirësimin e funksionalitetit të regjistrimit kombëtar, dhe trajnimet për institucionet, si dhe pavarësinë financiare të organeve të mbikëqyrjes së auditimit, duke ofruar një udhërrëfyes për zbatimin efektiv të *acquis-it*.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i politikës është përafrimi i plotë me standardet evropiane, siç përcaktohet në Direktivën (BE) 2017/1132 dhe amendimet e saj, për të avancuar negociatat teknike të Kapitullit 6 dhe për të mundësuar anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ky harmonizim synon të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e veprimtarive, modernizimin e infrastrukturës digjitale për të mbështetur shkëmbimin e informacionit dhe transaksionet ndërkufitare, si dhe rritjen e besueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e mjedisit të biznesit në Shqipëri.

Në nivel makro, objektivat e RIA-s përqendrohen në përafrimin e plotë të ligjit të për regjistrimin e biznesit me Direktivën (BE) 2017/1132 dhe amendimet e saj, për të nxitur progresin në negociatat e Kapitullit 6 dhe për të përmbushur kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, duke ndërtuar një kuadër ligjor të qëndrueshëm dhe transparent që lehtëson veprimtaritë vendase dhe ndërkufitare të bizneseve. Kjo përfshin përmirësimin e infrastrukturës digjitale për ndërveprueshmërinë e regjistrave të biznesit dhe shkëmbimin e informacionit synon të lehtësojë transaksionet ndërkufitare dhe të integrojë Shqipërinë në tregun e brendshëm të BE-së, duke reduktuar pengesat ligjore dhe duke ndërtuar besim tek investitorët ndërkombëtarë përmes standardeve të larta të raportimit financiar dhe praktikave të qeverisjes korporative.

Ligji shqiptar duhet të harmonizohet me standardet e BE-së për të siguruar lëvizjen e lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe personave, si dhe për të krijuar një kuadër ligjor transparent për shoqëritë që operojnë në BE. Kjo do të lehtësojë operacionet ndërkufitare dhe krijimin e shoqërive nën rregulla të qarta dhe të hapura. Përshtatja me ligjin të BE-së do të ndihmojë Shqipërinë të krijojë një mjedis ligjor të njëjtë me shtetet anëtare të BE-së, duke siguruar që shoqëritë të mund të operojnë më lirshëm dhe efikasht përtej kufijve. Shqipëria duhet të sigurojë që shoqëritë të mund të operojnë lehtësisht brenda tregut të BE-së dhe të angazhohen në bashkime dhe shndërrime ndërkufitare me më pak pengesa ligjore. Objekti qendror ka krijimi i rregullave të qarta dhe transparente për shpalljen e informacionit, duke siguruar që investitorët dhe palët e tjera të kenë akses në informacion të besueshëm. Në këtë drejtim duhet të adresohet nevoja për më shumë digjitalizim të regjistrimit të shoqërive dhe ndërveprueshmërinë e regjistrave të biznesit për shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet regjistrave dhe lehtësimin e transaksioneve ndërkufitare brenda BE-së.

Objektivat e kësaj politike reformuese janë vendosur në përputhje të drejtpërdrejtë me problemin dhe shkaqet e tij, duke qenë një zgjerim i objektivave të përmendura edhe në Përmbledhjen Ekzekutive, por këtu në mënyrë më të detajuar. Objektivat kryesorë mund të përmbledhen si vijon:

- **Harmonizimi ligjor me BE-në:** Përafrimi i plotë i kuadrit ligjor shqiptar që rregullon shoqëritë tregtare dhe regjistrimin e tyre me **acquis**-në e BE-së (në veçanti me Direktivën (BE) 2017/1132 dhe aktet e lidhura me të). Kjo nënkupton miratimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme ligjore që do të mundësojnë zbatimin e kërkesave të BE-së mbi digjitalizimin e proceseve të biznesit, shkëmbimin ndërkufitar të të dhënave të regjistrit tregtar dhe standardet bashkëkohore të qeverisjes së korporatave.
- **Digjitalizimi dhe efienca:** Lehtësimi dhe digjitalizimi i procedurave të regjistrimit dhe operimit të biznesit, duke i bërë ato më të shpejta, më pak burokratike dhe me kosto më të ulëta administrative. Kjo përfshin zhvillimin e platformave elektronike (online) për regjistrimin e shoqërive dhe depozitimin e dokumenteve, përdorimin e nënshkrimit elektronik, ofrimin e informatave dhe formularëve standard në internet, si dhe ndërlidhjen elektronike të regjistrit të biznesit shqiptar me sistemet ndërkombëtare si BRIS.
- **Transparenca dhe qeverisja korporative:** Përmirësimi i transparencës së shoqërive tregtare dhe forcimi i standardeve të qeverisjes korporative. Ky objektiv përfshin masa si: garantimin e së drejtës së aksionarëve (sidomos atyre të vegjël) për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje; publikimin e informacionit kyç mbi shoqëritë dhe degët e tyre (statusi ligjor, administratori, pronarët përfitues, etj.) në përputhje me standardet e BE-së; inkurajimin e praktikave të mira, siç është **barazia gjinore** në organet drejtuese të shoqërive të listuara në bursë, në linjë me politikat evropiane për diversitetin gjinor në bordet korporative.
- **Rritja e besimit dhe investimeve:** Krijimi i një mjedisi biznesi më të besueshëm dhe të parashikueshëm, i cili të nxisë rritjen e Investimeve të Huaja Direkte (FDI) dhe investimeve vendase. Përmes harmonizimit ligjor dhe përmirësimit të proceseve, synohet që investorët t'i shohin operacionet në Shqipëri si më pak të rrezikuara dhe të ngjashme me praktikën e vendeve të BE-së, gjë që mund të ndikojë pozitivisht në vendimet e tyre për të investuar. Njëkohësisht, rritja e transparencës dhe e zbatimit të rregullave do të përmirësojë konkurrencën e ndershme në tregun vendor.
- **Përmbushja e detyrimeve integruese:** Plotësimi i detyrimeve të dalura nga MSA-ja dhe nga procesi i integritetit (kapitulli i **acquis** që lidhet me të drejtën e shoqërive dhe shërbimet), brenda afateve të planifikuara në dokumentet strategjike. Ky objektiv lidhet me arritjen në kohë të rezultateve legjislativë të kërkuara, në mënyrë që Shqipëria të mund të mbyllë me sukses detyrimet e saj para hapjes së negociatave të anëtarësimit në këtë fushë. Arritja e këtij objekti do ta afrojë vendin me qëllimin final të anëtarësimit në BE, duke treguar seriozitet dhe efektivitet në zbatimin e reformave të kërkuara.

Të gjithë këta objektiva janë formuluar në mënyrë specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të kufizuara në kohë (SMART). Për shembull, harmonizimi me direktivat e BE-së mund të matet përmes numrit të akteve ligjore të transpozuar; digjitalizimi i procedurave mund të matet me përqindjen e aplikimeve online krahasuar me ato fizike; përmirësimi i transparencës mund të vlerësohet nga indikatorë si pozicioni në indekset ndërkombëtare (p.sh. Indeksi i Lehtësisë së të Bërit Biznes ose indikatorë të qeverisjes korporative); ndërsa përmbushja e detyrimeve integruese matet drejtpërdrejt nga vlerësimet e Komisionit Evropian në raportet e progresit. Këta objektiva janë gjithashtu në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentet kombëtare strategjike, siç është Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0 (status quo)- nënkupton vijimin me kuadrin ligjor aktual. Nëse vlerësohet të zgjidhet ky opsion, do të vijohet me sistemet aktuale pa kërkuar veprime legjislative shtesë. Po ky opsion nuk është i mundur dhe as i përshtatshëm për t'u zbatuar për disa arsye. Së pari, anëtarësimi në BE kërkon përafrim të plotë me *acquis-in*, siç përcaktohet nga kriterit të Kopenhagenit vendosur nga Këshilli i Europës në vitin 1993, për "aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit" që burojnë nga të qenit vend anëtar. Shqipëria është e detyruar të përafrojë plotësisht legjislacionin e saj me *acquis-in* e BE-së dhe të zhvillojë kapacitete institucionale për ta zbatuar atë, siç përcaktohet gjithashtu nga Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe procesi i negociatave të anëtarësimit. Së dyti, vetë Manuali për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) i Këshillit të Ministrave të vitit 2016 nuk e lejon zgjedhjen e status quo-së si opsion kur harmonizimi është i detyrueshëm. Mbajtja e kuadrit aktual do të çonte në mos përputhshmëri të vazhdueshme me direktivat kryesore të BE-së, si Direktiva e Kodifikuar 2017/1132 Kjo do të pengonte harmonizimin ligjor dhe infrastrukturor, duke e bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve për transpozim dhe, rrjedhimisht, duke rezultuar në mosanëtarësimin në BE dhe moszbatimin e politikave kombëtare për integrim, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).. Pa veprim, kapaciteti institucional i Shqipërisë do të mbetej i pamjaftueshëm për të menaxhuar kompleksitetin e Direktivës së Kodifikuar për shoqëritë tregtare.

Opsioni 1 (Ndryshime në legjislacionin ekzistues) – nënkupton kryerjen e ndërhyrjeve përmirësuese në ligjin aktual. Ky është opsioni i preferuar, pasi parashikon shtimin dhe modifikimin e neneve ekzistuese të ligjit nr. 131/2015, me qëllim integrimin e kërkesave të reja (si ato për digjitalizimin, ndërlidhjen e regjistrave dhe transparencën korporative) brenda kornizës aktuale ligjore. Kjo qasje merr parasysh se ligji ekzistues ka tashmë strukturat dhe procedurat bazë të krijuara, duke e bërë më të thjeshtë dhe më eficient inkorporimin e elementeve të rinj, në vend të hartimit të një ligji nga e para. Miratimi i një ligji të ri nga ana tjetër, nënkupton hartimin e një ligji krejtësisht të ri për fushën në fjalë, që do të zëvendësonte ligjin nr. 131/2015. Ky opsion është vlerësuar si i papërshtatshëm dhe i panevojshëm në këtë fazë. Hartimi i një ligji të ri do të kërkonte kohë dhe burime shtesë të konsiderueshme, ndërkohë që objektivat mund të arrihen edhe përmes amendimeve të ligjit aktual. Për më tepër, ruajtja e strukturës aktuale duke e plotësuar atë me elemente të reja garanton vazhdimësi institucionale dhe shmang paqartësitë apo kostot e panevojshme administrative që do të sillte një ligj i ri krejtësisht.

Opsioni 2 (Jo rregullator)

Një qasje jo rregullatore do të nënkuptonte lejimin e bizneseve dhe aktorëve të tjerë relevantë të funksionojnë pa një kuadër të detajuar rregullator ose me ndërhyrje minimale nga shteti. Në këtë opsion, bizneset do të kishin lirinë për të vetë-rregulluar dhe për t'u pajtuar vullnetarisht me standardet bazë të BE-së, pa asnjë detyrim ligjor për të zbatuar rregulla të detajuara që lidhen me formimin e shoqërive, të drejtat e aksionarëve, operacionet ndërkufitare ose qeverisjen korporative.

Në kontekstin e harmonizimit të ligjit shqiptar me direktivën 2017/1132, ky opsion jo rregullator do të sugjeronte që shoqëritë të veprojnë në mënyrë të pavarur pa detyrime ligjore të plota ose kufizime të qarta. Për shembull, shoqëritë nuk do të ishin të detyruara të miratonin mjete digjitale të standardizuara për operacione si formimi i shoqërive ose bashkimet, as nuk do të kishte kërkesa të detyrueshme për transparencën e aksionarëve, ose harmonizimin me kornizën e BE-së për operacionet ndërkufitare. Megjithatë, ky opsion nuk mund të konsiderohet si një mundësi e vlefshme për Shqipërinë për disa arsye:

1. Si një shtet kandidat për në BE, dhe në zbatim të nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar ligjërisht të harmonizojë legjislacionin e saj kombëtar me rregulloret e BE-së si pjesë e procesit të integritetit në BE. Bashkimi Evropian ka vendosur një kuadër rregullator të detyrueshëm, në të cilin

shtetet anëtare duhet të funksionojnë, veçanërisht në fushat e ligjit të shoqërive, operacioneve ndërkufitare dhe qeverisjes korporative. Mospajtuueshmëria me këto rregullore do të minonte procesin e integritetit të Shqipërisë dhe do ta shtynte më tej anëtarësimin e saj në BE.

2. Mungesa e një kuadri të qartë rregullator do të krijonte pasiguri të konsiderueshme për investitorët, bizneset dhe aktorët relevantë. Pa një grup të rregullave të detajuara në vend, Shqipëria nuk do të mund të garantojë mbrojtjen e investimeve, funksionimin e duhur të tregut të brendshëm dhe konkurrencën e drejtë. Bizneset nuk do të kishin sigurinë se investimet e tyre janë të mbrojtura, veçanërisht në fusha si bashkimet, të drejtat e aksionarëve dhe transparenca e shoqërive. Ky skenar do të çonte në tërheqjen e pakët të investimeve të huaja, të cilat janë thelbësore për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.
3. Bashkimi Europian kërkon masa specifike për të mbrojtur interesat e palëve të interesuara, për të siguruar transparencë dhe për të promovuar praktika të drejta biznesi. Një qasje jo rregulatore do të injoronte këto kërkesa dhe do të lënte Shqipërinë jashtë përputhshmërisë me BE-në. Një situatë e tillë do të pengonte Shqipërinë të merrte pjesë plotësisht në tregun e brendshëm të BE-së dhe mund të rezultonte në sanksione ose barriera tregtare me shtetet anëtare të BE-së.
4. Nëse do të lihen shoqëritë dhe institucionet të vetë-regullohen, do të ketë një rrezik të madh për praktika të pasqaruara, ku disa biznese mund të përmbushin praktikën më të mira ndërkombëtare ndërsa të tjera jo. Ky skenar do të çonte në një treg të fragmentuar ku shoqëritë që respektojnë standardet ndërkombëtare do të ishin në një pozitë disavantazhi krahasuar me ato që shmangin detyrimet rregulatore. Kjo gjithashtu do të dobësonte aftësinë e shtetit për të monitoruar dhe zbatuar përputhshmërinë ligjore në mënyrë efektive, duke çuar në mundësi të abuzimit dhe praktika të padrejta.
5. Qëllimi i strategjisë së integritetit të Shqipërisë në BE është harmonizimi i standardeve të saj me ato europiane për të fituar akses në përfitimet e anëtarësimin, si rritja ekonomike, stabiliteti politik dhe integriteti në treg. Një qasje jo rregulatore do të shkelte këtë strategji dhe do të funksiononte kundër objektivave për miratimin e ligjeve dhe kuadrave përputhëse me BE-në.

Kjo mund të sillte transpozimi i pjesshëm (duke implementuar disa elemente dhe duke lënë mënjanë disa të tjera për më vonë). P.sh. elementet e Direktivës 2019/1151 janë të ndërlidhura dhe synojnë një paketë të integruar masash. P.sh. lidhja në BRIS pa pranuar identifikimin elektronik të huajve do të zgjidhte pjesërisht shkëmbimin e të dhënave, por sërish nuk do t'u jepte mundësi qytetarëve të huaj të përdorin plotësisht sistemin tonë; anasjelltas, pranimi i eID pa u lidhur në BRIS do t'u lejonte disa të huaj të regjistronin firma, por pa arritur transparencën ndër-regjistrore të plotë. Opsioni i shtyrjes (pra transpozimi, por më vonë se 2025) do të thotë zvarritje e përfitimeve dhe rrezik që legjislacioni ynë të mos jetë gati kur të nevojitet. Disa vende anëtare (p.sh. Polonia)⁶ e shtynë afatin me 1 vit për shkak të vështirësive teknike, por këto ishin shtyrje minimale. Për Shqipërinë, tashmë jemi disa vite pas afatit origjinal 2021; një vonesë e mëtejshme do të ishte e pajustifikuar.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

e) *Identifikoni grupet e prekura.*

f) *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

g) *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- b. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- c. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
- d. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*

h) *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*

⁶ <https://link.springer.com/article/10.1007/s40804-023-00282-6#:~:text=All%20of%20the%20mentioned%20provisions,Footnote%2065>

- a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- b. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

i) *Diskutoni kufizimin e analizës:*

- a. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- b. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

j) *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- a. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- b. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- c. *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga ndryshimet ligjore janë:

1. **Shoqëritë tregtare**, përfshirë degët e shoqërive të huaja.
2. **Investitorët e huaj dhe vendas.**
3. **Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV).**
4. **Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).**
5. **Institucionet publike mbështetëse:** MEKI, AKSHI, INSTAT.
6. **Shoqëria civile, mediat, publiku i gjerë.**

Llojet e ndikimeve sipas grupeve të prekura

Ndikimet ndahen në:

- **Ndikime të drejtpërdrejta:** Prekin menjëherë palët e interesuara në momentin e zbatimit të ligjit (p.sh. ndryshimet në procedura, depozitimi i dokumenteve, ndërlidhja ndërkufitare).
- **Ndikime të tërthorta:** Shfaqen në mënyrë graduale dhe ndikojnë në mjedisin më të gjerë ligjor dhe ekonomik (p.sh. përmirësimi i klimës së biznesit, transparenca, rritja e konkurrencës).

h) Ndikimet e drejtpërdrejta

a. Përshkrimi cilësor

- **Shoqëritë tregtare:** Do të përballen me detyrime të reja për dorëzimin e dokumenteve standarde, përditësimin e të dhënave dhe transparenca më të lartë. Përfitimet përfshijnë rritje të besueshmërisë ligjore dhe përmirësim të aksesit në tregjet ndërkombëtare.
- **QKB:** Do të përfitojë nga modernizimi dhe digjitalizimi i funksioneve, si dhe nga ndërlidhja me sisteme evropiane. Do të rrisë rolin si platformë qendrore për informacionin ligjor të biznesit.
- **Investitorët dhe kreditorët:** Do të kenë qasje më të lehtë në informacion mbi shoqëritë, duke mundësuar analiza më të sakta dhe vendimmarrje më të informuar.

b. Analizë sasiore cilësore

Ndikimet e drejtpërdrejta pritet të përfshijnë:

- Rritje të përdorimit të dokumenteve dygjuhëshe nga shoqëritë.
- Reduktim të kohës për përpunimin e kërkesave ndërkufitare.
- Rritje të besimit dhe të dukshmërisë së bizneseve shqiptare për palët e huaja.

c. Vlerësimi monetar – nuk aplikohet (nuk përfshihet me kërkesë).

d. Ndikimi te NMV-të

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përfitojnë nga:

- Përdorimi i procedurave të thjeshtuara dhe të digjitalizuara.
- Mundësi për t'u bërë të dukshme në nivel evropian nëpërmjet platformave të ndërlidhura.
- Akses më i lehtë në informacion dhe modele standarde për përgatitjen e dokumenteve

i) Ndikimet jo të drejtpërdrejta

a. Përshkrimi cilësor

- **Përmirësim i klimës së biznesit**, përmes harmonizimit me BE-në dhe rritjes së transparencës.
- **Rritje e llogaridhënies** së shoqërive tregtare përballë publikut, aksionarëve dhe kreditorëve.
- **Nxitje e formalizimit** në sektorin privat përmes rregullave të unifikuara.

b. Ndikimi mbi konkurrencën

- **Konkurrencë më e ndershme** midis shoqërive që zbatojnë rregullat dhe atyre që nuk e kanë bërë më parë.
- **Harmonizim i kushteve konkurruese** me vendet e BE-së përmes standardizimit të procedurave dhe kërkesave për transparencë.
- Reduktim i avantazheve të padrejta për operatorët informalë.

j) Kufizimet e analizës

a. Supozime dhe risqe

- Supozohet implementim i koordinuar nga të gjitha institucionet përkatëse.
- Supozohet që palët private do të jenë të gatshme të adaptojnë procedurat e reja.
- Risqet përfshijnë: vonesa në zbatim, kapacitete teknike të pamjaftueshme, mungesë ndërgjegjësimi te përdoruesit fundorë.

b. Faktorë që mund të pengojnë përfitimet

- Mungesa e koordinimit ndërinstitutional.
- Vonesa në miratimin e akteve nënligjore.
- Komunikim i pamjaftueshëm me bizneset dhe shoqatat profesionale.
- Rezistencë nga subjekte që janë mësuar me rregulla më të lehta.

k) Përmbledhje e vlerësimit të opsioneve

a. Pasqyrë përmbledhëse e ndikimeve

Opsioni	Ndikim cilësor
Status quo	Nuk zgjidh problemet ekzistuese. Mungesë progresi në harmonizim.
Ndryshim në ligjin ekzistues	Rrit transparencën, harmonizon me BE-në, zbatim i shpejtë dhe i qartë.
Ligj i ri	Përmban të njëjtat përfitime, por me kosto më të lartë zbatimi dhe paqartësi në tranzicion.
Opsion jorregullator	Nuk përmbush detyrimet ndaj BE-së. Rrezik i fragmentimit të tregut.

b. Krahasimi cilësor i opsioneve

- **Opsioni i ndryshimeve në ligjin ekzistues** ofron përfitimin maksimal me ndikim pozitiv të menjëhershëm dhe përballeshmëri institucionale.
- **Opsioni i ligjit të ri** është i panevojshëm për nivelin e ndërhyrjes e cila është minimale
- **Status quo** dhe **opsioni jorregullator** nuk adresojnë thelbin e problemit dhe nuk janë në përputhje me objektivat integruese të Shqipërisë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në vlerësimin e mësipërm dhe analizën e plotë të ndikimeve, **opsioni i preferuar është Opsioni 1**, që konsiston në ndryshimin e legjislacionit ekzistues (amendimet në ligjin nr. 131/2015). Ky opsion doli më i favorshmi nga krahasimi i opsioneve, pasi arrin të balancojë më së miri objektivat e politikës me kosto të pranueshme dhe me një shkallë të lartë realizueshmërie.

Gjatë procesit të analizës, u vlerësuan kriteret kryesore që përcaktojnë suksesin e ndërhyrjes dhe u krahasuan opsionet lidhur me secilin kriter. Siç u pa në tabelën e vlerësimit, Opsioni 1 kryeson në shumicën dërrmuese të kriterëve. Arsyetimi për këtë zgjedhje mund të përmbledhet në pikat e mëposhtme:

- **Efektiviteti në përmbushjen e objektivave:** Ndryshimet në ligjin ekzistues adresojnë drejtpërdrejt boshllëqet e identifikuar – duke futur dispozita për shkëmbimin ndërkufitar të të dhënave, digjitalizimin e procedurave dhe rritjen e transparencës – pa krijuar vakuum ligjor apo pa ndryshuar rrënjësisht strukturat institucionale. Kështu, objektivat strategjikë arrihen shpejt dhe me siguri më të madhe.
- **Përdorimi i kuadrit ligjor ekzistues:** Duke amenduar një ligj ekzistues, shfrytëzohen mekanizmat institucionalë tashmë në vend (struktura e QKB-së, procedurat e regjistrimit që tashmë funksionojnë, etj.), gjë që redukton ndjeshëm **kostot administrative** dhe ato të zbatimit. Administrata dhe bizneset janë tashmë të familjarizuara me ligjin 131/2015; ndryshimet e propozuara do t'i **harmonizojnë dhe përmirësojnë** ato, në vend që të imponojnë një regjim krejtësisht të ri.
- **Fleksibiliteti dhe koha e zbatimit:** Opsioni 1 lejon një **zbatim më të shpejtë**. Amendamentet e ligjit mund të hartohen dhe miratohen brenda një afati relativisht të shkurtër, duke qenë se përfitojnë nga baza ekzistuese. Një ligj krejt i ri (Opsioni 2) do të kërkonte më shumë kohë për konsultime dhe hartim, si dhe për adaptimin institucional pas miratimit. Ndërsa opsioni i preferuar siguron që Shqipëria të mos humbasë kohë në përmbushjen e detyrimeve ndaj BE-së dhe në ofrimin e përfitimeve konkrete për biznesin.
- **Minimizimi i risqeve dhe pasigurive:** Amendimi i ligjit aktual paraqet më pak rreziqe juridike e praktike, pasi **nuk e zhbën arkitekturën ekzistuese ligjore**, por e fuqizon atë. Kjo u jep aktorëve (institucioneve zbatuese dhe bizneseve) një **qartësi dhe stabilitet** më të madh gjatë tranzicionit drejt rregullave të reja. Gjithashtu, përmes konsultimeve dhe eksperiencës së deritanishme me ligjin ekzistues, qeveria ka një ide më të qartë mbi atë çfarë funksionon dhe çfarë duhet ndryshuar – duke ulur gjasat e gabimeve apo pasojave të papritura.

Përmbledhtazi, Opsioni 1 është zgjedhur sepse ai maksimizon përfitimet neto të reformës: përmirëson legjislacionin në përputhje me standardet evropiane, forcon institucionet dhe praktikat ekzistuese, dhe e bën këtë në një mënyrë të zbatueshme dhe të përballeshme. Ky opsion ofron efikasitet më të lartë (në krahasim me status quo-në, që lë problemin pa zgjidhur) dhe efektivitet më të lartë (në krahasim me opsionin e ligjit të ri, që do të vononte zgjidhjen dhe do të rriste kostot). Kështu, opsioni i preferuar përfaqëson rrugën më racionale për të arritur objektivat e përcaktuara të politikës.

Kostot Buxhetore

Kostot buxhetore të implementimit të Opsionit 1 janë disa, por të menaxhueshme në kuadrin e strategjisë më të gjerë të integrimit të Shqipërisë në BE. Investimet e nevojshme do të drejtohen kryesisht në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë programe trajnimi për profesionistët, krijimin e infrastrukturës

digjitale dhe për operacionet ndërkufitare Gjithashtu, financimi do të jetë i nevojshëm për konsultime, këshilla nga ekspertë dhe kostot administrative të miratimit dhe zbatimit të ligjeve të reja.

Duke qenë se e kemi të pamundur të kryejmë një analizë sasiore të ndikimeve ekonomike të opsionit të preferuar, pasi kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në vlerë monetare rezulton i pjesshëm dhe i vështirë për t'u bërë, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet metodën e analizës me shumë kriterë.

Si rezultat kemi identifikuar 5 kriterë me rëndësi për të vlerësuar:

- Përmirësimi, harmonizimi dhe qartësimi i kuadrit ligjor lidhur me shoqëritë tregtare mbi bazën e ligjeve ekzistuese - 4
- Përfshirja e bashkimit, ndarjes ndërkufitare, mbrojtjes aksionare etj në ligje tashmë të njohura – 3;
- Krijimi i mekanizmave për përafrim digjital; - 4
- Efikasiteti në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimi me efikasitet i kuadrit ligjor.-3
- Kosto më të njohura administrative; - 3

Këto kriterë janë vlerësuar me pikë për secilin opsion si vijon:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Përmirësimi, harmonizimi dhe qartësimi i kuadrit ligjor lidhur me shoqëritë tregtare mbi bazën e ligjeve ekzistuese	4	0 (0)	3 (12)	0 (0)
Përfshirja e bashkimit, ndarjes ndërkufitare, mbrojtjes aksionare etj në ligje tashmë të njohura	3	0 (0)	3 (9)	2(6)
Krijimi i mekanizmave për përafrim digjital	4	0 (0)	4 (16)	0(0)
Efikasiteti në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimi me efikasitet i kuadrit ligjor.	3	2 (6)	3 (9)	2 (6)
Kosto më të njohura administrative;	3	0 (0)	2 (6)	0 (0)
Pikët		6	52	12

Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret e përmendura si më lart, duke vlerësuar secilin opsion, rezulton se opsioni 1 ka numrin më të lartë të pikëve me 52 krahasuar me opsionet e tjera.

Çështje të zbatimit

1. Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
2. Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
3. Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.

Për zbatimin me sukses të opsionit të zgjedhur (ndryshimet ligjore në ligjin ekzistues), është e nevojshme përcaktimi i qartë i strukturave përgjegjëse, marrja e masave paraprake për kapërcimin e pengesave të mundshme si dhe planifikimi i hapave konkretë të implementimit. Më poshtë paraqiten aktorët kryesorë që do të luajnë rol në zbatim, së bashku me detyrat dhe sfidat përkatëse:

- **Ministria përgjegjëse për ekonominë** – Si institucioni kryesor që mbulon politikën ekonomike dhe reformat rregullatore, kjo ministri do të ketë rol udhëheqës në procesin e zbatimit. Ajo do të ndjekë gjithë procedurën nga hartimi i akteve nënligjore të nevojshme, deri te koordinimi me institucionet e tjera. Ministria do të sigurojë harmonizimin e plotë me direktivat e BE-së, do të drejtojë fushatat informuese për palët e prekura (bizneset, shoqatat profesionale), si dhe do të ndjekë performancën e përgjithshme të reformës. Gjithashtu, kjo ministri do të angazhohet në dialogun me strukturat e BE-së për raportimin e përparimit dhe do të përpiqet të sigurojë mbështetje teknike apo financiare (p.sh. projekte asistence) për zbatimin sa më efektiv të ndryshimeve.
- **Ministria përgjegjëse për financat** – Kjo ministri, ndër të tjera, luan rolin e koordinatorit kombëtar për aspektet financiare të integritit dhe harmonizimit ligjor me BE-në. Në kuadër të zbatimit të kësaj reforme, Ministria e Financave do të sigurojë që ndryshimet ligjore të jenë në përputhje edhe me politikat fiskale dhe buxhetore. Një nga detyrat kryesore do të jetë vlerësimi i **kostove financiare** të implementimit (si p.sh. zhvillimi i sistemeve të reja elektronike, trajnimi i stafit, fushatat informuese) dhe alokimi i fondeve të nevojshme. Ministria e Financave, përmes strukturave të integritit, do të monitorojë gjithashtu që reformat të përmbushin kriteret makro-fiskale të BE-së, duke mos krijuar barrë të paqëndrueshme financiare.
- **Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)** – Si institucioni që do të preket drejtpërdrejt nga ndryshimet (duke qenë zbatuesi kryesor i shumicës së tyre), QKB-ja do të jetë përgjegjëse për zbatimin praktik të reformës. Kjo nënkupton **përshtatjen e proceseve të brendshme** të QKB-së me ndryshimet ligjore: azhurnimin e sistemit elektronik të regjistrimit të biznesit, integrimin e modulit për ndërlidhjen me regjistrat evropiane (BRIS), publikimin e materialeve dygjuhëshe (shqip dhe anglisht) në faqen e saj zyrtare, etj. QKB-ja do të punojë ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe me Autoritetin për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) për të siguruar që infrastruktura teknologjike mbështet në mënyrë të sigurt dhe efektive shërbimet e reja të digjitalizuara. Një aspekt kyç do të **jetë** lidhja e regjistrit të biznesit shqiptar me sistemin e ndërlidhjes së regjistrave të BE-së (BRIS) – për këtë qëllim, pasi të finalizohen specifikimet teknike nga AKSHI dhe QKB, do të ndërmerren hapat konkretë për implementimin e lidhjes dhe testimin e saj.

Gjatë zbatimit, një sërë pengesash të mundshme duhen pasur parasysh dhe adresuar: rezistenca ndaj ndryshimit nga disa grupe interesi (p.sh. biznese që mund të kenë vështirësi fillestare me proceset e reja elektronike), kufizimet teknologjike ose vonesa në zhvillimin e sistemeve IT, nevoja për trajnimin e personelit të QKB-së dhe institucioneve të tjera, si dhe koordinimi ndërinstitutional. Është e domosdoshme hartimi i një plani të detajuar të implementimit me afate dhe përgjegjës konkretë, si dhe mbështetja e fortë politike e reformës, në mënyrë që të gjitha institucionet të lëvizin në të njëjtin drejtim pa vonesa.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

4. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
5. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i kësaj nisme ligjore do të jenë komponentë kyç për të siguruar që ndryshimet e miratuara të japin rezultatet e dëshiruara dhe për të identifikuar me kohë çfarë funksionon apo ku nevojiten korrigjime. Duke qenë se Komisioni Evropian e ndjek nga afër përparimin e Shqipërisë në përmbushjen e reformave, krijimi i një mekanizmi të fuqishëm monitorimi do të adresojë njëkohësisht kërkesat e brendshme për llogaridhënie dhe ato të jashtme (ndaj BE-së).

Në raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024, është nënvizuar se Shqipëria duhet të përmirësojë kapacitetet institucionale për monitorimin dhe zbatimin e reformave në fushën e ligjit të shoqërive. Raporti vëren se progresi aktual në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së – veçanërisht ato që lidhen me digjitalizimin e shërbimeve dhe operacionet ndërkufitare (bashkimet, ndarjet, shndërrimet) – ka qenë relativisht i ngadaltë, me boshllëqe si në transpozim ashtu edhe në zbatim. Rekomandimi kryesor i BE-së është forcimi i mekanizmave të monitorimit të implementimit të ndryshimeve ligjore, për t'u siguruar që ato të zbatohen në praktikë në mënyrë efektive dhe brenda afateve. Në këtë kontekst, Shqipëria duhet të fokusohet në përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve kyçe (si p.sh. ministritë përgjegjëse, QKB, gjykatat që kanë rol në regjistrimin e shoqërive, etj.), në mënyrë që çdo pengesë a vonesë në zbatim të evidentohet dhe zgjidhet shpejt. Gjithashtu, është e nevojshme të investohet në ndërtimin e kapaciteteve të këtyre institucioneve – nëpërmjet trajnimeve, rekrutimit të stafit të kualifikuar dhe përmirësimit të infrastrukturës teknologjike – për t'u siguruar që ato kanë burimet e duhura për të zbatuar në mënyrë efektive kuadrin e ri ligjor. Krijimi i sistemeve të qarta të monitorimit dhe raportimit do të ndihmojë në ndjekjen e ecurisë së reformës dhe vlerësimin e ndikimit të saj, duke i mundësuar qeverisë që të marrë masa korrigjuese në kohë. Këto hapa do ta ndihmojnë Shqipërinë të arrijë përputhshmërinë e plotë me standardet e BE-së në ligjin e shoqërive dhe njëkohësisht do të përmirësojnë mjedisin e biznesit, duke nxitur rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, do të krijohet një mekanizëm i dedikuar monitorimi, i cili do të funksionojë në baza periodike (p.sh. raporte tremujore dhe vjetore). Ky mekanizëm do të udhëhiqet nga Ministria përgjegjëse për ekonominë, në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante. Do të ngrihet një grup pune ndërinstitutional i monitorimit, i cili do të mbledhet rregullisht për të shqyrtuar progresin e zbatimit të reformës. Ky grup do të përfshijë përfaqësues nga: ministritë e linjës, QKB, AKSHI, sistemi gjyqësor (për çështjet që lidhen me regjistrimin ligjor të shoqërive), INSTAT, si dhe nga shoqëria civile ose komuniteti i biznesit (në cilësinë e vëzhguesve, për të dhënë kontributin e tyre).

Monitorimi do të fokusohet në aspektet kyçe të implementimit: (1) nëse janë nxjerrë të gjitha aktet nënligjore brenda afateve të parashikuara; (2) nëse QKB-ja ka vënë në funksion të gjitha mjetet e reja digjitale (si p.sh. portalin e ri online, lidhjen me BRIS, publikimin e formularëve standard, etj.); (3) nëse është zhvilluar fushata informuese dhe programet e trajnimit; dhe (4) nëse institucionet po bashkëpunojnë normalisht në shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe me homologët e huaj. Çdo devijim nga plani (p.sh. vonesë në zbatimin e një komponenti) do të raportohet dhe do të shoqërohet me propozime për korrigjim.

Vlerësimi do të jetë i lidhur ngushtë me monitorimin, por i fokusuar te rezultatet dhe ndikimet. Pas një periudhe të caktuar (p.sh. një vit nga hyrja në fuqi, dhe më pas në mënyrë periodike çdo vit), do të kryhen vlerësime të hollësishme për të matur nëse objektivat e politikës po arrihen dhe në çfarë shkalle. Këto vlerësime do të marrin parasysh feedback-un nga komuniteti i biznesit, statistikave të mbledhura nga INSTAT dhe institucionet e tjera, si dhe analizat kualitative (p.sh. studime rasti, sondazhe me përdoruesit e shërbimeve të QKB-së).

Kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre: Për të siguruar një vlerësim sa më objektiv dhe të matshëm, janë identifikuar një sërë treguesish kryesorë të performancës (Key Performance Indicators, KPI) lidhur me çdo objektiv të politikës. Këta tregues do të përdoren si baza mbi të cilën grupi i monitorimit dhe vlerësimit do të gjykojë suksesin ose nevojën për përmirësime të mëtejshme. Disa nga treguesit kryesorë janë:

- **Përputhshmëria ligjore:** Niveli i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me direktivat dhe rregulloret e BE-së (i matur si përqindje e transpozimit të plotë). Ky tregues do të vlerësohet duke kontrolluar nëse të gjitha kërkesat e Direktivës 2017/1132 dhe akteve të tjera relevante janë reflektuar në ligjet dhe rregulloret shqiptare, dhe nëse janë zbatuar praktikisht nga institucionet. Një përputhshmëri afër 100% do të tregonte sukses në këtë drejtim.
- **Rritja e investimeve të huaja direkte (FDI):** Evolucioni i fluksit të IHD-ve pas implementimit të reformës. Pritshmëria është që përmirësimi i klimës së biznesit dhe siguria e shtuar ligjore do të

reflektohen në një trend rritës të investimeve të huaja. INSTAT dhe Banka e Shqipërisë do të raportojnë të dhëna mbi nivelin e FDI-ve çdo vit; një rritje, sidomos në sektorët e lidhur me shoqëritë tregtare, do të jetë tregues pozitiv i ndikimit të reformës.

- **Përmirësimi i klimës së biznesit:** Ky tregues do të vlerësohet nëpërmjet pozicionit dhe skorjes së Shqipërisë në raporte ndërkombëtare si *Indeksi i Lehtësisë së të Bërit Biznes* (Doing Business) ose raporte të tjera të OECD/BERZH që matin mjedisin rregullator. Në veçanti, komponenti i “fillimit të një biznesi” (që lidhet me procedurat e regjistrimit) pritet të përmirësohet (p.sh. ulja e numrit të ditëve dhe procedurave për regjistrim, nëse reformat e digjitalizimit janë efektive). Gjithashtu, sondazhet me bizneset vendase mund të shërbejnë si tregues: përqindja e bizneseve që shprehen të kënaqura me shërbimet e QKB-së pas reformës, krahasuar me më parë.
- **Ndikimi të bizneset në përgjithësi dhe të ndërmarrjet e vogla e të mesme (NMV) në veçanti:** Kjo do të matet me disa nën-tregues. Një prej tyre është numri i regjistrimeve të reja të biznesit (në rritje, nëse procedurat janë lehtësuar). Një tjetër është përqindja e bizneseve që përdorin platformat online për regjistrim dhe për shërbime të tjera (në rritje, nëse digjitalizimi ka sukses). Gjithashtu, do të monitorohet nëse ka ndonjë kosto shtesë për bizneset për shkak të reformës (p.sh. nevoja për pajisje me nënshkrim elektronik) dhe nëse po, a është kjo kosto e përballueshme sidomos për NMV-të. Nëpërmjet feedback-ut nga dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit do të vlerësohet gjithashtu nëse NMV-të po përshtaten lehtësisht me ndryshimet apo nëse hasin ndonjë vështirësi specifike.
- **Zbatimi i standardeve të qeverisjes korporative:** Këtu do të vlerësohet përmirësimi në praktikën e kompanive, veçanërisht shoqërive aksionare dhe atyre të listuara, në drejtim të transparencës dhe qeverisjes. Tregues konkretë mund të jenë: (i) numri i shoqërive të listuara që kanë të paktën 30% gra në bordin drejtues (si një matje e barazisë gjinore), (ii) numri i rasteve të evidentuara të abuzimeve me të drejtat e aksionarëve minoritarë (pritsmëria është ulje e këtyre rasteve pas forcimit të kornizës ligjore), (iii) niveli i zbatimit të kërkesave të reja për raportim dhe transparencë (p.sh. përqindja e shoqërive aksionare që publikojnë informacione të plota sipas formatit të ri të kërkuar).
- **Përmirësimi i kapaciteteve institucionale:** Ky tregues mat aspektin e qëndrueshmërisë së reformës brenda institucioneve. Do të mbledhen të dhëna mbi numrin e trajnimeve të kryera për stafin e QKB-së dhe institucioneve të tjera, numrin e stafit të ri të rekrutuar ose të ri-destinuar për të mbuluar funksionet e reja, si dhe mbi investimet në infrastrukturë (p.sh. zhvillimi i sistemeve të TI, i portalit të ri online, i moduleve të reja të ndërlidhjes me sistemet e huaja). Gjithashtu, do të ndiqet performanca e institucioneve si Autoriteti i Konkurrencës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, AKSHI, etj., në rolin e tyre mbështetës – p.sh. nëse Autoriteti i Konkurrencës vëren ndonjë tendencë për rritjen e konkurrencës jolojale pas reformës, apo nëse Dhoma e Noterisë has ndonjë problem me aktet e reja standarde elektronike, këto do të raportohen.

Këta tregues do të përdoren rregullisht për të monitoruar progresin. Grupet e monitorimit do t'i përfshijnë në raportet e tyre periodike, duke i krahasuar vlerat aktuale me ato bazë (para reformës) dhe me objektivat e synuara. Kur treguesit tregojnë progres të pamjaftueshëm ose devijime, autoritetet do të analizojnë shkaqet dhe do të propozojnë masa korrigjuese – që nga ndërhyrjet shtesë ligjore (nëse nevojitet ndonjë amendim për shkak të ndonjë paqartësie të dalë në pah gjatë zbatimit), deri te shtimi i burimeve ose ndryshimi i metodologjisë së implementimit. Në këtë mënyrë do të sigurohet që objektivat e politikës të realizohen me efektivitet dhe brenda afateve të planifikuara, duke e bërë reformën e qëndrueshme dhe të suksesshme në afatgjatë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Në analizën e mëposhtme janë marrë në konsideratë vetëm përfitimet për arsye se kostot janë jo vetëm të papërcaktueshme me besueshmëri, por edhe sepse vlera e tyre është jo e rëndësishme krahasimisht me përfitimet. Vlerat janë vendosur nga vlerësime empirike por edhe duke marrë parasysh vlerësimet e Komisionit Europian.

Shifrat në tabelë janë të shprehura në milionë (000 000) Lekë.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472

Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	472	448.4	429.52	410.64	387.04	372.88	354	335.12	320.96	306.8
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	3,837									
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	3,837									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	-	3,837	3,837
Opsioni 2	0	0	0
Opsioni 3			

MINISTËR

BLENDI GONXHJA